

## PROCES VERBAL

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

*“Hartimi i projektit të detajuar Inxhinierik dhe arkitektonik dhe ndertimi i godines se stacionit Hekurudhor te Aeroportit te Rinasit” (Kontratë me çelësa në dorë),*

**Punë ndërtimi - 45000000-7**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 91,665,395.06 Leke** ( Nëntëdhjetë e një milionë, gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë, treqind e nëntëdhjetë e pesë pikë zero gjashtë.) pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 (ndryshuar me ligjin nr.16/2024, datë 08.02.2024) “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024) autoriteti/enti kontraktor ”Hekurudha Shqiptare sh.a” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 79, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik *(ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është e bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin, 43 pika 2 gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021(ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024) “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

### 2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se **50%** e vlerës së fondit limit , të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës së fondit limit te.

### **Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e bën oferten të kualifikueshme.**

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - *Kontratë Sipërmarrje;*
  - *Situacionin përfundimtar;*
  - *Aktin e kolaudimit*
  - *Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);*
  - *Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.*
  - *Faturat Tatimore .*

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

**Shënim :** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - *Kontratë Sipërmarrje*
  - *Situacionin përfundimtar;*

- *Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.*
- *Leje ndertimi*
- *Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- *Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.*
- *Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

### **Argumentimi:**

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 2,3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit të kontratës.*

*Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

## **2 - PROJEKTUES ARKITEKT**

- a- *Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.*
- b-3. *objekte spitalore; терминалет në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.*
- c- *Projektim interiere.*
- d- *Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.*

## **Argument për licencën – PROJEKTUES ARKITEKT**

Objekti i “**Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit**” përbën një infrastrukturë komplekse publike me funksione të shumëfishta, që përfshin hapësira pritjeje, shërbimi, qarkullimi dhe integrimi me transportin ajror dhe tokësor. Për këtë arsye:

- (a) Kërkohej projektim arkitekturor i avancuar për një objekt me karakter publik dhe funksionalitet të ngjashëm me objekte industriale dhe terminale transporti, duke garantuar standarde të larta sigurie, funksionaliteti dhe estetike.
- (b-3) Stacioni përfshihet në kategorinë e terminalëve në infrastrukturë, duke kërkuar ekspertizë specifike në projektimin e hapësirave të fluksit të lartë të pasagjerëve dhe integrimin me sistemet ekzistuese të transportit.
- (c) Projektimi i interiorit është thelbësor për organizimin funksional të hapësirave të brendshme (salla pritjeje, sportele, akseset), duke ndikuar drejtpërdrejt në përvojën dhe orientimin e përdoruesve.
- (d) Projektimi i peizazhit dhe sistemimi i hapësirave të jashtme është i domosdoshëm për integrimin e objektit me ambientin përreth, duke përfshirë zona të gjelbra, qarkullim këmbësorësh dhe akseset hyrëse/dalëse.

Kërkesa për këtë licencë është e justifikuar nga natyra multifunktionale, kompleksiteti teknik dhe rëndësia publike e objektit.

## **3 - PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

- a - *Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.*
- b-2 *Objekte me skelet metalik.*
- c-1 *Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme - metalike*
- e- *Objekte civile e turistike prej druri.*

## **Argument për licencën – PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

Për projektin “**Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit**”, kërkesa për licencën e projektuesit konstruktor është plotësisht e justifikuar për shkak të kompleksitetit strukturor dhe kërkesave të larta të sigurisë:

- (a) Objekti përfshin struktura civile me elementë beton arme (salla pritjeje, ambiente shërbimi, struktura mbështetëse), që kërkojnë projektim sipas standardeve për ngarkesa të larta dhe përdorim publik intensiv.
- (b-2) Përdorimi i skeleteve metalike është i zakonshëm në stacione dhe terminale për mbulime me hapësira të mëdha (çati, platforma), duke kërkuar ekspertizë specifike në projektimin dhe analizën e tyre.
- (c-1) Projekti klasifikohet me shkallë të lartë vështirësie, për shkak të kombinimit të materialeve (beton arme dhe metal), ngarkesave dinamike nga trenat, fluksit të lartë të pasagjerëve dhe kërkesave sizmike, duke kërkuar analizë të avancuar strukturore.

- (e) Elementët ndihmës arkitektonikë apo funksionalë mund të përfshijnë edhe struktura druri (mbulesa dekorative, elementë peizazhi), që kërkojnë projektim të specializuar.

Natyra e projektit si infrastrukturë transporti me kërkesa të larta teknike dhe sigurie justifikon plotësisht kërkesën për këtë licencë në të gjitha kategoritë përkatëse.

#### **4 - PROJEKTUES INSTALATOR**

- b. *Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.*
- c. *Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.*
- d. *Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.*
- f. *Projektim të sistemeve kundra zjarrit.*
- g. *Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.*
- i. *Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj*
- j. *Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., pwr objektet civile e industrial*

#### **Argument për licencën – PROJEKTUES INSTALATOR**

Për projektin “**Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit**”, kërkesa për licencën e projektuesit instalator është thelbësore për shkak të kompleksitetit të sistemeve teknologjike dhe funksionimit të pandërprerë të objektit:

- (a) Objekti kërkon **instalime hidro-termosanitare** për furnizim me ujë, kanalizime dhe menaxhim të ujërave, të dimensionuara për fluks të lartë përdoruesish.
- (b) Nevojiten **sisteme termoteknike dhe kondicionimi (HVAC)** për të garantuar komoditet dhe cilësi ajri në hapësira të mëdha publike, si dhe integrim i mundshëm i **burimeve të rinovueshme** për eficiencë energjetike.
- (c) Kërkohe projektim i **rrjeteve elektrike** për furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt të të gjitha funksioneve të stacionit dhe sistemeve ndihmëse.
- (f) Duke qenë objekt me fluks të lartë publik, është i domosdoshëm projektimi i **sistemeve kundra zjarrit** sipas standardeve të sigurisë.
- (g) Implementimi i **sistemeve të monitorimit dhe automatizimit (BMS)** është i nevojshëm për menaxhimin efikas të instalimeve dhe operimit të objektit.
- (i) Projektimi i **ndriçimit të jashtëm dhe të brendshëm**, përfshirë sheshet dhe zonat e aksesit, është thelbësor për siguri, orientim dhe funksionalitet, në përputhje me standardet për infrastrukturë transporti.
- (j) Objekti kërkon **rrjete komunikimi dhe sigurie** (telefonja, interneti, CCTV, access control, alarm, detektim zjarri), të cilat janë kritike për operimin dhe sigurinë e pasagjerëve.

Integrimi i shumë sistemeve teknologjike në një objekt transporti publik justifikon plotësisht kërkesën për këtë licencë në të gjitha kategoritë përkatëse.

#### **5 - PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE**

- b. - Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.*
- c.- Ujësjellës-kanalizime urbane – rurale.*
- d. - Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin*
- f. - Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.*

### **Argument për licencën – PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE**

Për projektin “**Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit**”, kërkesa për licencën e projektuesit të veprave hidraulike është e domosdoshme për garantimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe të sigurt të ujërave dhe infrastrukturës përkatëse:

- (b)** Objekti kërkon projektim të **sistemeve të furnizimit me ujë dhe kolektorëve të shkarkimit**, të dimensionuara për përballimin e fluksit të lartë të përdoruesve dhe operimit të vazhdueshëm të stacionit.
- (c)** Integrimi me **rrjetet urbane të ujësjellës-kanalizimeve** është thelbësor për funksionimin normal të objektit dhe lidhjen e tij me infrastrukturën ekzistuese të zonës.
- (d)** Nevojiten zgjidhje për **kullimin dhe menaxhimin e ujërave sipërfaqësore**, duke përfshirë sistemet e drenazhimit për mbrojtjen e objektit dhe platformave nga përmytjet.
- (f)** Projekti mund të përfshijë **vepra hidroteknike specifike**, si sisteme të avancuara shkarkimi të ujërave të tepërta, struktura për marrje dhe devijim uji, si dhe elementë të mbrojtjes hidraulike të infrastrukturës hekurudhore dhe të objektit.

Kompleksiteti i menaxhimit të ujërave, lidhja me rrjetet ekzistuese dhe nevoja për mbrojtje nga rreziqet hidraulike justifikojnë plotësisht kërkesën për këtë licencë në të gjitha kategoritë përkatëse.

### **6 - PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA**

*a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.*

### **Argument për licencën – PROJEKTUES RRUGË – HEKURUDHA**

Për projektin “**Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit**”, kërkesa për këtë licencë është e domosdoshme për shkak të lidhjes funksionale të objektit me infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore:

- (a)** Projekti përfshin **akseset rrugore**, hyrje-daljet, rrugët lidhëse dhe sistemimin e qarkullimit në zonën e stacionit, të cilat klasifikohen si rrugë urbane dhe interurbane dytësore, duke kërkuar projektim sipas standardeve të trafikut dhe sigurisë.

Gjithashtu, integrimi i stacionit me **linjën hekurudhore** dhe organizimi i platformave, kthesave, niveleve dhe elementëve të sigurisë kërkon ekspertizë të specializuar në këtë fushë.

Projekti duhet të garantojë **qarkullim efikas dhe të sigurt** për automjete, transport publik dhe këmbësorë, duke menaxhuar flukse të larta dhe ndërthurjen e mënyrave të ndryshme të transportit.

Natyra e projektit si nyje transporti multimodal justifikon plotësisht kërkesën për këtë licencë.

## **8 - PROJEKTUES GJEODET**

*a - Rivetime inxhinierike.*

*c - Sisteme GIS.*

*d - Bazamente gjeodezike.*

*e.- Projektim fotogrametrik dhe hartografik.*

### **Argument për licencën – PROJEKTUES GJEODET**

Për projektin “**Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit**”, kërkesa për licencën e projektuesit gjeodet është thelbësore për sigurimin e saktësisë geometrike dhe mbështetjes teknike në të gjitha fazat e projektimit dhe zbatimit:

**(a)** Kërkohen **rivetime inxhinierike të detajuara** për përcaktimin e saktë të topografisë, kufijve dhe elementëve ekzistues të terrenit, si bazë për projektimin.

**(c)** Përdorimi i **sistemeve GIS** është i nevojshëm për menaxhimin dhe analizimin e të dhënave hapësinore, si dhe për integrimin e projektit me infrastrukturat ekzistuese.

**(d)** Ndërtimi i **bazamenteve gjeodezike** siguron referencat e nevojshme për vendosjen e saktë të objektit dhe kontrollin gjatë zbatimit të punimeve.

**(e)** **Projektimi fotogrametrik dhe hartografik** është i domosdoshëm për krijimin e hartave të sakta dhe modeleve digjitale të terrenit, veçanërisht për një zonë me rëndësi infrastrukturore dhe zhvillim kompleks.

Kërkesat për saktësi të lartë, koordinim ndërdisiplinor dhe integrim me rrjetet ekzistuese e bëjnë të domosdoshme këtë licencë për realizimin e projektit.

## **9. - STUDIM GJEOLOGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK**

*a-Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.*

*e.- Studime e projekte hidrogjeologjike.*

### **Argument për licencën – STUDIM GJEOLOGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK**

Për projektin “**Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit**”, realizimi i studimeve gjeologo-inxhinierike dhe hidrogjeologjike është thelbësor për garantimin e sigurisë strukturore dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të objektit:

- (a) Kërkohe**t studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit** për përcaktimin e karakteristikave fiziko-mekanike të tokës, kapacitetit mbajtës, sjelljes ndaj ngarkesave dhe kushteve sizmike, duke shërbyer si bazë për projektimin e themeleve dhe strukturave mbështetëse.
- (e) **Studimet hidrogeologjike** janë të domosdoshme për identifikimin e nivelit të ujërave nëntokësore, rrjedhjeve dhe ndikimeve të mundshme në strukturë, si dhe për projektimin e masave të mbrojtjes nga uji dhe drenazhimit.

Kushtet e truallit dhe prania e mundshme e ujërave nëntokësore në zonën e projektit e bëjnë të domosdoshme këtë licencë për të garantuar projektim të sigurt, ekonomik dhe të qëndrueshëm.

#### **10. - PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË ENERJISË ELEKTRIKE**

- c- Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj.*
- e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.*

#### **Argument për licencën – PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Për projektin “**Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit**”, kërkesa për këtë licencë është e justifikuar nga nevoja për furnizim të sigurt, efikas dhe të qëndrueshëm me energji elektrike:

- (c) Integrimi i **impianteve të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme** (p.sh. panele fotovoltaike) është i rëndësishëm për rritjen e eficiencës energjetike, uljen e kostove operative dhe përmbushjen e standardeve mjedisore për infrastrukturën moderne të transportit.
- (e) Projekti kërkon projektimin e **kabinave elektrike dhe rrjeteve të shpërndarjes (TU/TM)** për furnizimin e qëndrueshëm të të gjitha sistemeve të stacionit (ndriçim, HVAC, sisteme sigurie, automatizim), duke garantuar siguri dhe vazhdimësi në operim.

Në përfundim, rëndësia e furnizimit të pandërprerë me energji dhe integrimi i teknologjive moderne energjetike justifikojnë plotësisht kërkesën për këtë licencë.

#### **11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR**

- a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.*

#### **Argument për licencën – PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR**

Për projektin “**Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit**”, kërkesa për këtë licencë është e domosdoshme për organizimin e sigurt dhe efikas të qarkullimit në zonën e stacionit:

- (a) Projekti përfshin **sinjalistikë jondriçuese** për rrugët hyrëse/dalëse, rrugët lidhëse urbane dhe interurbane dytësore, si dhe për **sheshet dhe parkimet**, duke garantuar orientim të qartë dhe menaxhim të trafikut.  
Duke qenë një nyje transporti me **fluks të lartë automjetesh dhe këmbësorësh**, sinjalistika është thelbësore për rritjen e sigurisë rrugore dhe shmangien e konflikteve të lëvizjes.  
Sinjalizimi duhet të jetë në përputhje me **standardet teknike dhe rregullat e qarkullimit**, duke siguruar integrim me rrjetin ekzistues rrugor dhe funksionim të koordinuar me infrastrukturën e stacionit.

Rëndësia e organizimit të trafikut dhe sigurisë në një zonë me intensitet të lartë përdorimi justifikon plotësisht kërkesën për këtë licencë.

## **12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE**

a. - Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

b. - Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

### **Argument për licencën – STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE**

Për projektin “Stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit”, realizimi i studimeve të sizmologjisë inxhinierike është thelbësor për garantimin e sigurisë strukturore dhe përputhshmërisë me standardet sizmike:

- (a) Kërkohen **studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike** për klasifikimin gjeosizmik të truallit, me qëllim përcaktimin e parametrave sizmike që ndikojnë në projektimin e strukturave dhe themeleve.
- (b) **Studimet gjeologo-sizmike** janë të domosdoshme për vlerësimin e sjelljes së truallit gjatë tërmeteve, duke përfshirë rreziqe si likuefaksioni, amplifikimi i valëve sizmike dhe qëndrueshmëria e shtresave të tokës.

Duke qenë se objekti është një infrastrukturë publike me rëndësi të veçantë dhe fluks të lartë përdoruesish, kërkesa për këtë licencë është e justifikuar për të garantuar projektim të sigurt dhe rezistent ndaj veprimeve sizmike.

### **2.3.3 Staf i kërkuar :**

*Operatori ekonomik ose bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të ketë të përfshirë si drejtues teknik dhe të figurojë në Licensën e shoqërisë, stafin e mëposhtëm:*

- *Projektues Arkitekt* 1 (një)
- *Projektues Strukturist* 1 (një)
- *Projektues Mekanik* 1 (një)
- *Projektues Elektrik* 1 (një)
- *Projektues Infrastruktura* 1 (një)
- *Projektues Gjeodet* 1 (një)
- *Projektues Gjeoteknik* 1 (një)
- *Ekspert Sigurie, Mbrojtje nga zjarri* 1 (një)

*Për stafin e mësipërm duhet paraqitur për secilin dokumentacioni provues si:*

- *Diploma*
- *CV personale*
- *Kontrata e Punës (e vlefshme ligjërish)*
- *Secili nga anëtarët e stafit të sipërcituar dhe të angazhuar, të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve për t’u realizuar objekt i kësaj kontratë në rast të shpalljes fitues.*

- *Stafi i sipërcituar të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.*

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues original ose kopje e noterizuar:

### **Argumentim: Baza ligjore**

- Ligji nr. 107/2014, i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 8402/1998, i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”;
- VKM nr. 943, datë 28.12.2016, për kriteret dhe procedurat e licencimit të profesionistëve në fushën e zhvillimit të territorit;
- Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 45, pika 1, shkronja “a”, kërkon që operatorët të demonstrojnë kapacitet teknik dhe profesional të mjaftueshëm.

Në projektet e infrastrukturës hekurudhore si “Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës Durrës–Tiranë”, që përfshin:

- Ndërtime sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Struktura betoni, metalike dhe ndihmëse
- Impiante elektrike, mekanike, ndriçimi, ujësjellës-kanalizime, drenazhime, etj.
- Studime të specializuara gjeologjike, gjeodezike, hidroteknike

është detyrimisht e nevojshme që projekti të hartohet nga një staf i plotë multidisiplinar, me përfaqësim profesional nga çdo fushë.

| Profili i kërkuar                           | Arsyeja teknike   |
|---|---|
| Projektues Arkitekt                         | Për konceptimin arkitektonik të strukturave ndihmëse, ambienteve teknike, terminaleve, etj. |
| Projektues Strukturist                      | Për llogaritjen e sigurisë strukturore të objekteve dhe veprave arti                        |
| Projektues Mekanik                          | Për impiantet termoteknike, kondicionimin dhe sistemet e zjarrit                            |
| Projektues Elektrik                         | Për rrjetin elektrik të objekteve dhe ndriçimin rrugor                                      |
| Projektues Infrastruktura (rrugë/hekurudhë) | Për projektimin planimetrik, profilin gjatësor e tërthor, kros-seksionet, trupin e rrugës   |

| Profili i kërkuar                           | Arsyeja teknike   |
|---|---|
| Projektues Gjeodet                          | Për matje, trasim dhe hartografi teknike  |
| Projektues Gjeoteknik                       | Për studime të tokës, kapacitet mbajtës dhe shpate  |
| <i>Ekspert Sigurie, Mbrojtje nga zjarri</i> | Siguron identifikimin e rreziqeve dhe projektimin e masave e sistemeve që mbrojnë njerëzit dhe objektin nga zjarri dhe emergjencat. |

Perfshirja e stafit ne listë pagesat e operatorit

- Garancia e përfshirjes reale në staf – Shumë operatorë shpesh paraqesin CV fiktive. Detyrimi për të qenë në licencë + listë pagesash për të paktën 3 muaj garanton se personi është realisht i brendshëm dhe i angazhuar me përgjegjësi në projekt.
- Drejtuesi teknik është kërkuar nga vetë VKM 943 si detyrim për të ligjëruar përgjegjësinë teknike të subjektit.
- Në mungesë të stafit të brendshëm të përfshirë dhe të licencuar, projekti rrezikon mungesë cilësie, bashkërendimi teknik dhe siguri.

Pse kërkohen dokumentet shoqëruese

|                                       |   |
|---------------------------------------|---|
| Diploma + CV personale                | Verifikimi i kualifikimeve dhe eksperiencës së kërkuar                            |
| Kontratë pune e (vlefshme ligjerisht) | Siguron se personi është i punësuar realisht dhe me detyrime                      |
| Deklaratë disponueshmërie             | Shmang përfshirjen e personelit të mbingarkuar ose me angazhime të tjera          |
| Listë pagesash 3 mujore               | Provon se personi është pjesë aktive e shoqërisë dhe jo i ftuar vetëm për aplikim |

**2.3.4** Numri minimal i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave (e Vërtetuar kjo me listë pagesat përkatëse, të Konfirmuar nga Drejtoria e Taimëve, sipas formularit E-Sig 02/a.)

:

**Argumentimi:** Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore e shoqëruara me listepagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e

tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

*2.3.5 Operatorët ekonomikë ne fushen e projektimit duhet të paraqesin prova të certifikimit nga organe të pavarura akredituese si më poshtë:*

**a) Çertifikatë ISO 9001:2015** të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë, dhe/ose të njëvlefshme me to që mund të garantojnë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në

Ligji 162/2020 “ Per Prokurimin Publik”, Neni 79 (**Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor**)

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të paraqesin **prova se disponojnë sisteme të përshtatshme të menaxhimit të cilësisë**, në përputhje me standarde europiane ose ndërkombëtare.”

VENDIM Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK ( i ndryshuar)  
Neni 44

“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të demonstrojnë **zbatimin e një sistemi të menaxhimit të cilësisë**, në përputhje me standardin ISO 9001 ose të barasvlershëm.”

**Ne lidhje me projektin:**

**-Siguria dhe cilësia e projektimit**

- ISO 9001:2015 siguron që subjektet që kryejnë projektimin:
  - Zbatojnë procedura të kontrolluara për kontrollin teknik, rishikimin dhe miratimin e dokumentacionit
  - Reduktojnë rrezikun e gabimeve inxhinierike dhe moskonformitetit
  - Sigurojnë gjurmueshmëri dhe auditueshmëri të gjithë procesit të projektimit

## **-Standard profesional i kërkuar për projekte infrastrukturore kombëtare dhe ndërkombëtare**

- ISO 9001 është standard i rekomanduar për konsulentët dhe projektuesit në sektorë si transporti, energjia, ndërtimet dhe mjedisi – veçanërisht në projektet me rëndësi strategjike si ne rastin tone linjat hekurudhore.

## **-Kusht për pjesëmarrje në prokurim dhe vlefshmërinë kontraktore**

- Subjektet pa sistem të certifikuar të cilësisë mund të skualifikohen nga procedurat e për zgjedhjes apo të konsiderohen të papërgatitura për projektet e ndërlikuara.

Posedimi i ISO 9001:2015 është një garanci objektive që ata janë në gjendje të zbatojnë procedura të standardizuara sipas kërkesave të kontratës.

**b) ISO 14001:2015 “Per sistemin e menaxhimit mjedisore” (te vlefshme) ose ekuivalent ne perputhje me objekt i tenderit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në

**-Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar**

- **Neni 5, pika 2:**

“Subjektet publike dhe private që ushtrojnë veprimtari me ndikim në mjedis, kanë për detyrë të **integrojnë parimet e mbrojtjes së mjedisit** në sistemet e tyre të menaxhimit dhe vendimmarrjes.”

- **Neni 25 – Vlerësimi i ndikimit në mjedis:**

“Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin jo vetëm përgatitjen e raportit, por edhe **përcaktimin e masave organizative dhe procedurave për menaxhimin e qëndrueshëm të ndikimeve mjedisore** gjatë fazës së projektimit dhe zbatimit.”

Kjo përfshin kërkesën për sisteme të organizuara dhe të verifikueshme të menaxhimit mjedisor.

Ligji 162/2020 “ Per Prokurimin Publik”, Neni 79 (**Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor**)

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik të provojë se është **në gjendje të zbatojë masa mjedisore të barasvlershme me një sistem të menaxhimit mjedisor të njohur ndërkombëtarisht**, të tilla si ISO 14001.”

VENDIM Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK ( i ndryshuar)

Neni 44

“Operatorët ekonomikë mund të kërkojnë të paraqesin **certifikata ose dëshmi për sisteme të menaxhimit mjedisor**, siç është standardi ISO 14001 ose ekuivalent.”

**Ne lidhje me projektin:**

**-Natyra e projektit kërkon menaxhim të qëndrueshëm mjedisor**

**“Hartimi i projektit te detajuar Inxhinierik dhe arkitektonik dhe ndertimi i godines se stacionit Hekurudhor te Aeroportit te Rinasit”:**

1. **Reduktimi i ndikimit mbi mjedisin urban dhe natyror:**
  - Projekti synon të minimizojë ndërhyrjet në peizazhin urban dhe zonat natyrore përgjatë trasës, duke ruajtur hapësirat e gjelbra dhe elementet ekzistuese mjedisore.
2. **Menaxhimi i ujërave dhe mbrojtja e resurseve hidrologjike:**
  - Integrimi i sistemeve të drenazhit, kapërderdhëseve dhe sifonave për të parandaluar përmytjet dhe ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
3. **Reduktimi i ndotjes së ajrit dhe zhurmës:**
  - Zbatimi i standardeve të qarkullimit hekurudhor për të ulur emetimet e ndotësve dhe ndotjen akustike, sidomos në zonat urbane pranë stacioneve dhe lagjeve banimi.
4. **Menaxhimi i materialeve dhe mbetjeve të ndërtimit:**
  - Planifikimi i riciklimit dhe trajtimit të materialeve ndërtimore për të minimizuar gjenerimin e mbetjeve dhe ndikimin në ambient.
5. **Rritja e efikasitetit energjetik dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme:**
  - Projektimi i impianteve të energjisë termike dhe sistemeve elektrike me eficiencë të lartë, duke reduktuar konsumin e energjisë dhe emetimet karbonike.
6. **Rritja e qëndrueshmërisë afatgjatë:**
  - Zbatimi i masave parandaluese dhe sistemeve monitoruese për të garantuar që infrastruktura hekurudhore funksionon në mënyrë të qëndrueshme pa dëmtime mjedisore në periudha afatgjata.
7. **Integrimi me planifikimin urban dhe komunitetin:**
  - Projektimi i linjës dhe stacioneve duke marrë parasysh ndikimin mbi komunitetin dhe duke siguruar përdorim të qëndrueshëm të hapësirave publike dhe rrugëve ndihmëse.

**ISO 14001:2015 është standardi ndërkombëtar për organizimin dhe monitorimin e detyrave mjedisore gjatë projektimit dhe zbatimit të projekteve.**

**-Siguron që subjekti projektues ka kapacitete të strukturuar për të:**

- Identifikuar, minimizuar dhe parandaluar ndikimet në mjedis
- Integruar masat mjedisore në fazën e projektimit
- Menaxhuar mbeturinat, ndotjen akustike, mbrojtjen e peizazhit dhe ndotjen e ujërave
- Dokumentuar dhe gjurmuar përputhshmërinë ligjore

**-Kriter për projekte publike, ndërkombëtare dhe të financuara nga donatorë**

- EIB, WBIF, BERZH dhe BE **kërkojnë ISO 14001 ose ekuivalent** për subjektet kontraktuese të angazhuara në projekte që kanë ndikim të ndjeshëm mjedisor.
- Është kusht për **kualifikimin** në shumë procedura konkurruese të nivelit të lartë.

**2.3.6/a** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

|          |   |
|----------|---|
| N.P – 1  | Punime gërmimi në tokë  |
| N.P – 2  | Ndërtime civile dhe industriale   |
| N.P – 3  | Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash                           |
| N.P – 4  | Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale                             |
| N.P – 7  | Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje  |
| N.P – 11 | Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë |
| N.P – 12 | Punime të inxhinierisë së mjedisit  |

**Për punimet speciale të ndërtimit:**

|          |  |
|----------|--|
| N.S – 2  | Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre  |
| N.S – 4  | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese |
| N.S – 6  | Sinjalistika rrugore jondriçuese   |
| N.S – 8  | Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri  |
| N.S – 12 | Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit  |
| N.S – 14 | Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV  |

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari*

ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

### **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

#### **Argumentim:**

#### **N.P-1 Punime gjurmimi në tokë**

Kjo kategori është e domosdoshme për realizimin e gjurmimeve për themelet, platformat, kanalet teknike dhe sistemimin e terrenit, duke siguruar përgatitjen e duhur të truallit për ndërtimin e objektit dhe infrastrukturës shoqëruese në përputhje me projektin.

#### **N.P – 2 Ndërtime civile dhe industriale**

Kjo kategori është e domosdoshme për realizimin e punimeve ndërtimore të objektit të stacionit, duke përfshirë strukturat, muret, çatitë dhe elementët funksionalë, në përputhje me projektin arkitektonik dhe konstruktiv.

#### **N.P – 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash**

Kjo kategori është e nevojshme për realizimin e punimeve të rikonstruksionit, mirëmbajtjes dhe përfundimeve të jashtme, duke përfshirë veshjet e fasadave, përmirësimet funksionale dhe estetike, si dhe garantimin e qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së objektit.

#### **N.P – 4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale**

Kjo kategori është e domosdoshme për realizimin e infrastrukturës së aksesit dhe lidhjes me stacionin, duke përfshirë rrugët hyrëse/dalëse, sheshet, parkimet dhe elementët e lidhjes me linjën hekurudhore, në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë së transportit.

#### **N.P – 7 Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje**

Kjo kategori është e domosdoshme për realizimin e rrjeteve të furnizimit me ujë dhe sistemeve të kanalizimit, si dhe për punimet e kullimit dhe drenazhimit, duke siguruar funksionimin normal të objektit dhe mbrojtjen e tij nga ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

#### **N.P – 11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë**

Kjo kategori është e domosdoshme për realizimin e infrastrukturës elektrike të objektit, duke përfshirë ndërtimin e kabinave elektrike, lidhjen me rrjetin e tensionit të ulët dhe të mesëm dhe sigurimin e shpërndarjes së qëndrueshme dhe të sigurt të energjisë për të gjitha funksionet e stacionit.

#### **N.P – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit**

Kjo kategori është e domosdoshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve, kontrollin e ndotjes, trajtimin e ujërave dhe rehabilitimin e zonës, në përputhje me standardet mjedisore dhe kërkesat ligjore.

#### **Për punimet speciale të ndërtimit:**

#### **N.S – 2 Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre**

Kjo kategori është e domosdoshme për instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve hidro-sanitare, duke përfshirë furnizimin me ujë, shkarkimet, si dhe pajisjet ndihmëse si kuzhina dhe ambiente shërbimi, duke garantuar funksionim higjieno-sanitar dhe operim të qëndrueshëm të objektit.

#### **N.S – 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese**

Kjo kategori është e domosdoshme për realizimin e punimeve të përfundimit të brendshëm dhe të jashtëm të objektit, duke përfshirë suvatime, veshje, punime me dru, metal, plastikë dhe xham, si dhe elementë teknikë ndërtues, duke garantuar cilësi estetike, funksionale dhe qëndrueshmëri të godinës.

#### **N.S – 6 Sinjalistika rrugore jondriçuese**

Kjo kategori është e domosdoshme për realizimin dhe vendosjen e sinjalistikës jondriçuese në rrugë, sheshe dhe parkime, duke siguruar orientimin e trafikut, rritjen e sigurisë rrugore dhe organizimin e qarkullimit në zonën e aksesit të stacionit hekurudhor të aeroportit.

#### **N.S – 8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri**

Kjo kategori është e domosdoshme për realizimin e elementeve strukturorë të parafabrikuar, si dhe strukturave metalike dhe prej druri, të cilat përdoren në ndërtimin e stacioneve dhe hapësirave me hapje të mëdha, duke garantuar shpejtësi ndërtimi, cilësi dhe qëndrueshmëri strukturore.

#### **N.S – 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit**

Kjo kategori është e domosdoshme për instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve HVAC dhe impianteve teknologjike, duke siguruar ngrohje, ftohje dhe ventilim të kontrolluar në ambientet e stacionit, si dhe funksionim efikas, komoditet dhe kushte optimale për përdoruesit dhe operimin e objektit.

#### **N.S – 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV**

Kjo kategori është e domosdoshme për realizimin e instalimeve të brendshme elektrike dhe sistemeve të komunikimit, duke përfshirë rrjetet telefonike, radiotelefoni dhe TV, me qëllim sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji dhe komunikimit funksional në të gjitha ambientet e stacionit hekurudhor.

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.*

**2.3.6/b** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Kjo licencë është e domosdoshme për menaxhimin e drejtë dhe të kontrolluar të mbetjeve që krijohen gjatë punimeve të ndërtimit, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së objektit, duke përfshirë grumbullimin, ruajtjen e përkohshme dhe transportin e tyre në venddepozitimet e miratuara. Ajo siguron që të gjitha mbetjet të trajtohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore, duke minimizuar ndikimin negativ në mjedis, ndotjen dhe rreziqet për

shëndetin publik. Gjithashtu, garanton gjurmueshmërinë dhe kontrollin e procesit të menaxhimit të mbetjeve gjatë gjithë ciklit të projektit.

### 2.3.7/a **Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :**

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

|                          |         |
|--------------------------|---------|
| a. Arkitekt              | 1 (një) |
| b. Inxhinier Ndërtimi    | 1 (një) |
| c. Inxhinier Strukturist | 1 (një) |
| d. Inxhinier Transporti  | 1 (një) |
| e. Inxhinier Mekanik     | 1 (një) |
| f. Inxhinier Elektrik    | 1 (një) |
| g. Inxhinier Gjeodet     | 1 (një) |
| h. Inxhinier Gjeoteknik  | 1 (një) |
| i. Inxhinier Mjedis      | 1 (një) |

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Librezë pune dhe Cv.  
Drejtuësit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.  
Njeri nga drejtuësit teknike duhet të jetë i pajisur me “ Çertifikate për Auditues Energjistik në ndërtesa “ lëshuar nga Agjencia për Efiçensën e Energjisë.

**Argumentimi:** *AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, mjedisit, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative,*

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

### **Argumentim:**

#### **Inxhinier Arkitekt:**

- Projektimin arkitektonik të objektit në aspekt funksional dhe estetik
- Organizimin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme sipas funksionit të stacionit
- Integrimin e objektit me infrastrukturën dhe mjedisin përreth
- Sigurimin e komoditetit, qarkullimit dhe orientimit të përdoruesve
- Përshtatjen e projektit me kërkesat teknike, urbanistike dhe operationale

#### **Inxhinier Ndërtimi**

- Projektin dhe dimensionon strukturat (beton, çelik, themele)
- Siguron që objekti të jetë i **qëndrueshëm dhe i sigurt**

- Kontrollon përputhshmërinë me **normat teknike dhe sizmike**
- Është baza kryesore e projektit konstruktiv

### **Inxhinier Strukturist**

- Projektimin dhe analizën strukturore të objektit (beton arme, metal, etj.)
- Sigurimin e qëndrueshmërisë dhe rezistencës ndaj ngarkesave statike dhe dinamike
- Llogaritjen e ndikimit të ngarkesave sizmike dhe kushteve të terrenit
- Projektimin e elementëve mbajtës (themele, kolona, trarë, soleta)
- Garantimin e sigurisë dhe stabilitetit strukturor gjatë gjithë jetës së objektit

### **Inxhinier Transporti**

- Analizon qarkullimin dhe aksesin rrugor
- Projektton rrugë, kryqëzime, hyrje-dalje
- Siguron **lëvizshmëri të sigurt dhe funksionale**
- Parandalon bllokime dhe rreziqe trafiku

### **Inxhinier Mekanik**

- Projektton sistemet HVAC (ngrohje, ftohje, ventilim)
- Sisteme kundër zjarrit dhe pajisje mekanike
- Siguron **komoditet dhe funksionim teknik të objektit**
- Rrit eficiencën energjetike

### **Inxhinier Elektrik**

- Projektton furnizimin me energji elektrike
- Ndriçimi, tokëzimi, mbrojtja nga mbingarkesat
- Siguron **siguri elektrike dhe funksionalitet**
- I domosdoshëm për çdo objekt modern

### **Inxhinier Gjeodet**

- Studion tokën dhe nëntokën
- Jep rekomandime për themelet
- Parandalon rrëshqitje, fundosje dhe dëmtime strukturore
- Thelbësor për **sigurinë afatgjatë të ndërtimit**

### **Inxhinier Gjeoteknik**

- Vlerësimin e karakteristikave të truallit dhe shtresave gjeologjike
- Projektimin e themeleve dhe ndërveprimit strukturë–tokë
- Analizën e stabilitetit të terrenit dhe rreziqeve gjeoteknike (ulje, rrëshqitje, likuefaksion)

- Vlerësimin e ndikimit të ujërave nëntokësore në strukturë
- Përcaktimin e masave për përmirësimin dhe stabilizimin e tokës për ndërtim të sigurt

#### **f. Inxhinier Mjedisi**

- Vlerëson ndikimin në mjedis
- Menaxhimi i ujërave, mbetjeve dhe ndotjes
- Siguron përputhje me ligjet mjedisore

Ndihmon në zhvillim të qëndrueshëm *Shenim: Bazuar ne Rekomandimin Nr.6732, date 21.10.2020 mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”, inxhinierët e mësipërm duhet te vetdeklarojne se ata jane te disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate*

**2.3.7/b** Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

|   |         |
|---|---------|
| - Teknik Ndërtimi   | 1 (dy)  |
| - Hidraulikë  | 2 (dy)  |
| - Elektracistë  | 3 (tre) |
| - Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse | 2 (dy)  |
| - Hekurkthyes   | 2 (dy)  |
| - Karpentier  | 3 (tre) |
| - Saldator dhe prerës të metaleve   | 1 (një) |
| - Specialist gipsi  | 1 (një) |
| - Punonjës duro-alumini   | 2 (dy)  |
| - Muratorë  | 2 (dy)  |
| - Suvatues  | 2 (dy)  |
| - Bojaxhi   | 2 (dy)  |
| - Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to                           | 2 (dy)  |

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

| <b>Nr.</b> | <b>Emër Mbiemër i punonjësit</b> | <b>Profesioni</b> | <b>Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës</b> | <b>Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)</b> |
|------------|----------------------------------|-------------------|---|---|
| 1          |                                  |                   |   |   |
| 2          |                                  |                   |   |   |
| etj        |                                  |                   |   |   |

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”.

### **Argumentim – disponimi i punonjësve të specializuar**

Kjo kërkesë është e domosdoshme për të garantuar realizimin cilësor, të sigurt dhe në kohë të punimeve të ndërtimit dhe instalimeve për projektin e stacionit hekurudhor të Aeroportit të Rinasit. Natyra komplekse e objektit kërkon angazhimin e një stafi të kualifikuar në disiplina të ndryshme, ku çdo profil kontribuon në faza specifike të zbatimit të projektit.

Punonjësit e specializuar në ndërtim, muraturë, suvatim, bojatisje dhe shtrime pllakash sigurojnë realizimin e punimeve të rifiniturës me cilësi të lartë dhe përputhje estetike e funksionale. Hekurkthyesit, karpentierët dhe saldatorët janë thelbësorë për realizimin e strukturave beton-arme dhe metalike, duke garantuar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e objektit. Elektricitistët, hidraulikët dhe specialistët e HVAC sigurojnë funksionimin e plotë të instalimeve teknike dhe sistemeve mbështetëse të objektit, ndërsa specialistët e materialeve duro-alumini dhe gipsi kontribuojnë në përfundimet arkitektonike dhe ndarjet funksionale të hapësirave.

Në tërësi, disponimi i këtij stafi të specializuar është thelbësor për të siguruar cilësinë e punimeve, respektimin e standardeve teknike dhe realizimin me sukses të një objekti me kompleksitet të lartë si stacioni hekurudhor i aeroportit.

**2.3.7/c** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per **3 (tre)** muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë.
- C.V

### **Argumentim – Drejtuesi Teknik i punimeve**

Kjo kërkesë është e domosdoshme për të garantuar drejtimin profesional, kontrollin teknik dhe përgjegjësinë e plotë gjatë zbatimit të punimeve në objekt. Drejtuesi Teknik siguron që të gjitha fazat e ndërtimit të realizohen në përputhje me projektin, standardet teknike, kushtet e sigurisë dhe legjislacionin në fuqi.

Prania e tij e vazhdueshme në objekt është thelbësore për koordinimin e punimeve, zgjidhjen e problematikave teknike në terren dhe garantimin e cilësisë së ekzekutimit. Kërkesa që ai të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, i paangazhuar në kontrata të tjera dhe i evidentuar në listëpagesa, siguron angazhim real dhe efektiv në projekt.

Dokumentacioni shoqërues (kontrata e punës, diploma dhe CV) vërteton kualifikimin profesional, eksperiencën dhe aftësinë e tij për të menaxhuar një projekt me kompleksitet të lartë si ndërtimi i stacionit hekurudhor të aeroportit.

**2.3.7/d** Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

### **Argumentim – Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**

Kjo kërkesë është e domosdoshme për të garantuar zbatimin e masave të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë gjatë gjithë procesit të ndërtimit të objektit. Duke qenë se punimet përfshijnë aktivitete me risk të lartë (punime ndërtimi, gërmime, struktura, instalime dhe punë në lartësi), prania e një specialisti të certifikuar është thelbësore për parandalimin e aksidenteve dhe menaxhimin e rreziqeve në kantier.

“Përgjegjësi për sigurinë dhe shëndetin në punë” siguron hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të sigurisë në kantier, në përputhje me Ligjin Nr. 10237 dhe VKM Nr. 312, duke garantuar respektimin e procedurave të punës së sigurt, trajnimin e punonjësve dhe përdorimin korrekt të pajisjeve mbrojtëse.

Kërkesa për kontratë pune dhe certifikatë përkatëse vërteton angazhimin real dhe kualifikimin profesional të këtij personi, ndërsa paraqitja e dokumentacionit në fazën e mëvonshme siguron verifikim të saktë dhe transparencë në procesin e prokurimit.

**2.3.7/e** Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) ekspert zjarrfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën individuale të punës;
- certifikatë/dëshmi kualifikimi.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

### **Argumentim – Ekspert zjarrfikës**

Kjo kërkesë është e domosdoshme për garantimin e sigurisë nga zjarri gjatë zbatimit të punimeve dhe më pas gjatë funksionimit të objektit, duke qenë se projekti përfshin një infrastrukturë publike me fluks të lartë përdoruesish dhe sisteme komplekse teknike.

Eksperti zjarrfikës i certifikuar nga PMNZH siguron vlerësimin e rreziqeve nga zjarri, kontrollin e masave parandaluese dhe zbatimin korrekt të kërkesave teknike për mbrojtjen nga zjarri në kantier dhe në objekt. Ai kontribuon në hartimin dhe verifikimin e rrugëve të evakuimit, sistemeve të detektimit dhe ndërhyrjes në raste emergjence, si dhe në respektimin e standardeve ligjore dhe teknike në fuqi.

Paraqitja e kontratës së punës dhe certifikatës përkatëse vërteton angazhimin real dhe kualifikimin profesional të specialistit, ndërsa verifikimi i dokumentacionit në fazën e kualifikimit siguron transparencë dhe përputhshmëri me kërkesat e sigurisë në prokurim publik.

**2.3.7/f** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Eskavatorist 2 (dy)
- Automakunist 3 (tre)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

### **Argumentim – Operatorë me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP) për eskavatorist dhe automakinist**

Kjo kërkesë është e domosdoshme për garantimin e realizimit të sigurt, efikas dhe profesional të punimeve të gërmimit, transportit dhe lëvizjes së materialeve gjatë ndërtimit të objektit.

Eskavatoristët e certifikuar sigurojnë kryerjen e punimeve të gërmimit, sistemimit të terrenit dhe punimeve të dheut në përputhje me projektin teknik, duke minimizuar rreziqet për strukturat ekzistuese dhe sigurinë në kantier. Automakinistët e kualifikuar garantojnë operimin e mjeteve të rënda të transportit dhe ndërtimit, duke mundur lëvizjen e materialeve në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar.

Kërkesa për DAP të lëshuar nga D.P.SH.T.RR dhe përputhje me rregulloren përkatëse siguron që operatorët të përdorin staf të trajnuar dhe të certifikuar sipas standardeve ligjore, duke rritur sigurinë në punë dhe cilësinë e zbatimit të projektit. Dokumentacioni provues garanton verifikimin e aftësive profesionale dhe transparencën në procesin e përzgjedhjes.

**2.3.7/g** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojnë fuqi punëtore prej 40 (dyzet) punonjes (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues) për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ndërsa ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **3 muajt** e fundit nga data e hapjes se ofertave.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **3 muajt** e fundit nga data e hapjes se ofertave

### **Argumentim – Fuqi punëtore minimale (40 punonjës)**

Kjo kërkesë është e domosdoshme për të garantuar kapacitetin real organizativ dhe teknik të operatorit ekonomik për realizimin e punimeve brenda afateve dhe standardeve të kërkuara për një projekt me kompleksitet të lartë si stacioni hekurudhor i Aeroportit të Rinasit.

Numri minimal prej 90 punonjësish (përfshirë stafin drejtues) siguron që operatori disponon burime njerëzore të mjaftueshme për të përballuar njëkohësisht punime të ndryshme si ndërtimi civil, strukturor, instalimet teknike dhe punimet e rifiniturës, pa krijuar vonesa apo ulje të cilësisë së zbatimit.

Dokumentacioni nga Sigurimet Shoqërore dhe listëpagesat për 3 muajt e fundit shërben si provë objektive e kapacitetit real të punësimit, duke garantuar që deklaratimet janë të verifikueshme dhe që stafi është realisht i angazhuar në aktivitetin e operatorit. Kjo rrit transparencën, besueshmërinë dhe sigurinë në realizimin e kontratës publike.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

| <b>Nr.</b> | <b>Mjete/pajisje teknike</b>                                  | <b>Sasia</b> | <b>Gjendja</b>         |
|------------|---|--------------|------------------------|
| 1          | Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton | 2 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 2          | Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 -20 ton          | 2 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 3          | Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1.5 - 3.5 ton                 | 2 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 4          | Ekskavator me zinxhirë  | 2 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 5          | Ekskavator me goma (mjet teknologjik)                         | 1 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 6          | Autobetoniere   | 2 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 7          | Autopompë betoni  | 1 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 8          | Vinç kullë  | 1 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 9          | Fadromë me goma (mjet teknologjik)                            | 1 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 10         | Autobot Uji   | 1 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 11         | Minieskavatore  | 2 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 12         | Dumper (mjet teknologjik me goma)                             | 1 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 13         | Pompë suvatimi  | 2 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 14         | Elektrosaldatriçe   | 1 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 15         | Moto gjenerator   | 1 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 16         | Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)                  | 3 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 17         | Vibrator betoni   | 2 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 18         | Betoniere kantieri  | 2 copë       | Në pronësi ose me qera |
| 19         | Tranxhe për perpunimin e hekurit te ndertimit                 | 1 copë       | Në pronësi ose me qera |

|    |  |        |  |
|----|--|--------|--|
| 20 | Kallëpe  | 300 m2 | Në pronësi ose me qera                           |
| 21 | GPS dhe Pajisje total station                          | 1 copë | Në pronësi ose me qera                           |
| 22 | Kontenier ndërtimi stacionar (zyrë)                    | 1 copë | Në pronësi ose me qera                           |
| 23 | Fabrikë për prodhim betoni e pajisur me leje mjedisore | 1 copë | Në pronësi ose me qira ose me kontratë furnizimi |
| 24 | Skeleri  | 300 m2 | Në pronësi ose me qera                           |
| 25 | Autovinc deri 2.5 ton                                  | 1 copë | Në pronësi ose me qera                           |
| 26 | Autobitumatriçe  | 1 copë | Në pronësi ose me qera                           |
| 27 | Asfaltoshtruese  | 1 copë | Në pronësi ose me qera                           |
| 28 | Rrul (kompresor)                                       | 1 copë | Në pronësi ose me qera                           |
| 29 | Grejder  | 1 copë | Në pronësi ose me qera                           |
| 30 | Autobot uji  | 1 copë | Në pronësi ose me qera                           |

**Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :**

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “d”. , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet

*që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër; ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

- **Kamion vetëshkarkues  $\geq 20$  ton** – nevojitet për transportin e volumeve të mëdha të dheut, materialeve dhe mbetjeve ndërtimore në distanca të gjata.
- **Kamion vetëshkarkues 10–20 ton** – përdoret për transport fleksibël të materialeve në sasi mesatare brenda dhe jashtë kantierit.
- **Kamionçinë 1.5–3.5 ton** – shërben për transport të materialeve të vogla, pajisjeve dhe furnizimeve në zona me akses të kufizuar.
- **Eskavator me zinxhirë** – për gërmime të thella dhe punime të rënda në terrene të vështira dhe jo të stabilizuara.
- **Eskavator me goma (mjet teknologjik)** – për gërmime dhe manovrim të shpejtë në zona urbane dhe sipërfaqe të përgatitura.
- **Autobetoniere** – për transportin dhe ruajtjen e betonit të freskët nga impianti deri në kantier.
- **Autopompë betoni** – për hedhjen e betonit në lartësi dhe zona me akses të vështirë.
- **Vinç kullë** – për ngritjen dhe montimin e elementëve të rëndë strukturorë në lartësi.
- **Fadromë me goma** – për ngarkim, sistemim dhe transport të materialeve në kantier.
- **Autobot uji** – për furnizim me ujë për punime ndërtimi, pluhurosje dhe përzierje materialesh.
- **Minieskavator** – për punime precize në hapësira të ngushta dhe zona të kufizuara.
- **Dumper (mjet teknologjik me goma)** – për transport të shpejtë të materialeve brenda kantierit në distanca të shkurtra.
- **Pompë suvatimi** – për aplikim të shpejtë dhe uniform të suvasë në sipërfaqe të mëdha.
- **Elektrosaldatriçe** – për punime saldimit në struktura metalike dhe elementë konstruktivë.
- **Moto gjenerator** – për furnizim emergjent me energji elektrike në rast ndërprerjesh.
- **Depozitë uji ( $\geq 2000$  L)** – për sigurimin e rezervës së ujit për punime dhe emergjenca në kantier.
- **Vibrator betoni** – për kompaktimin e betonit dhe eliminimin e boshllëqeve ajrore.
- **Betoniere kantieri** – për përgatitjen e sasive të vogla të betonit direkt në kantier.
- **Tranxhe për përpunimin e hekurit të ndërtimit** – për prerjen dhe përkuljen e hekurit sipas projektit.
- **Kallëpe** – për formimin e elementëve beton-arme në dimensione të sakta.
- **GPS dhe Total Station** – për matje të sakta topografike dhe kontroll gjeodezik të punimeve.
- **Kontenier ndërtimi (zyrë)** – për organizimin administrativ dhe teknik të kantierit.
- **Fabrikë betoni me leje mjedisore** – për prodhimin e betonit të kontrolluar sipas standardeve cilësore dhe mjedisore.
- **Skeleri** – për punime në lartësi dhe akses të sigurt në fasada dhe struktura.

- **Autovinc deri 2.5 ton** – për ngritje dhe montim të elementeve të lehta në kantier.
- **Autobitumatriçe** – për transport dhe shtrirje të materialeve bituminoze në rrugë dhe sipërfaqe.
- **Asfaltoshtruese** – për shtrimin e asfaltit në rrugë dhe sheshe me cilësi uniforme.
- **Rrul (kompresor)** – për ngjeshjen e asfaltit dhe shtresave të rrugës.
- **Grejder** – për nivelim dhe profilim të saktë të terrenit dhe shtresave rrugore.
- **Autobot uji** – për lagjen e sipërfaqeve, kontrollin e pluhurit dhe mbështetje në punime ndërtimi.

**2.3.9** Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI** mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

#### **Argumentimi:**

##### **a. Certifikatë ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë**

*Zbatimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas standardit ISO 9001:2015 është i domosdoshëm për të garantuar organizim, kontroll dhe përmirësim të vazhdueshëm të*

*proceseve gjatë realizimit të projektit. Ky standard siguron cilësi të qëndrueshme në projektim dhe zbatim, rrit besueshmërinë e shërbimeve të ofruara dhe garanton përputhshmëri me kërkesat teknike, kontraktuale dhe ligjore në fuqi.*

***b. Certifikatë ISO 14001:2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor***

*Zbatimi i standardit ISO 14001:2015 është i domosdoshëm për menaxhimin e ndikimeve mjedisore që rrjedhin nga aktivitetet e projektit. Ky sistem siguron kontroll të ndotjes, menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtje të mjedisit, si dhe garanton përputhshmëri me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe politikat e zhvillimit të qëndrueshëm.*

***c. Certifikatë ISO 45001:2018 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë***

*Zbatimi i standardit ISO 45001:2018 është i nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve gjatë zhvillimit të aktivitetit ndërtimor. Ky sistem kontribuon në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve profesionale, parandalimin e aksidenteve dhe krijimin e një mjedisi pune të sigurt, duke garantuar përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë në punë.*

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 - 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.

**Argumentim – Kontratë me laborator testimi të betonit**

Kjo kërkesë është e domosdoshme për të garantuar kontrollin e cilësisë së materialeve ndërtimore, veçanërisht betonit dhe elementëve strukturorë, gjatë realizimit të punimeve. Kontrata me një laborator të akredituar siguron kryerjen e testeve sipas standardeve SSH EN dhe ISO përkatëse, duke verifikuar karakteristikat fiziko-mekanike të betonit, çelikut dhe elementëve të tjerë strukturorë. Kjo garanton përputhshmërinë me projektin teknik, sigurinë strukturore, qëndrueshmërinë afatgjatë të objektit dhe minimizimin e rreziqeve gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të tij.